REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
PRANUAR 09/01/2025
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
|---|---|---|---|
| 01 | 060/01 | 1477 | |

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
Zyra e Kryetarit

**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB)**

**IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)**

**Komuna / Opština: Drenas  Data / Datum: 08.01.2025**

**Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 6**

**Takim i rregullt / Redovni sastanak** ☒  **Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak** ☐

**Numri i anëtarëve të KKSB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 13**

**A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSB-së?**
**Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?**

Po / Da ☐
Jo / Ne ☒
Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☒

**A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSB-së?**
**Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?**

Po / Da ☐
Jo / Ne ☒
*Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë*

*Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju*

***Përfaqësues të KFOR-it***

**A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari?**

**Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?**

Po / Da ☒

Jo / Ne ☐

**Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:**
Në mbledhjen e mbajtur me datë 24.10.2024 u diskutuan këto pika të rendit të ditës:

1. *Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur më datë 24.10.2024.*
2. *Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit.*
3. *Hartimi i Planit Vjetor të Punës së KKSB-së për vitin 2025.*
4. *Orari i mbledhjeve të KKSB-së për vitin 2025.*
5. *Të ndryshme*

*Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:*

**Konkluzionet / Zaključci:**
Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur mbledhjen e gjashtw (6) për këtë vit ku të pranishëm ishin 13 anëtarë të KKSB-së që përfaqësojnë komunitet dhe organizatat në komunën e Drenasit dhe përfaqësues nga KFOR-i.

1. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.** Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 24.10.2024 është miratuar unanimisht nga të gjithë anëtarët e pranishëm të KKSB-së.

2. **Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit**
Komandanti i Stacionit Policor në Drenas, Driton Morina, raportoi se gjendja e sigurisë në komunë është përgjithësisht e qetë, me një ulje të ndjeshme të veprave penale krahasuar me vitin e kaluar. Ai gjithashtu informoi për angazhimin e forcave policore në Zubin Potok, pas shpërthimit në kanalin e ujit të Ibër-Lepencit.

3. Raport mbi fushatën për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore.

Udhëheqësja e NJKDNJ-së dhe BGJ-së, Zahrie Podrimqaku-Subashi, prezantoi aktivitetet e

zhvilluara në kuadër të Muajit Ndërkombëtar për Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (18 Tetor-17 Nëntor). Këto aktivitete përfshinin ligjërata vetëdijësuese në shkolla nga zyrtarë policorë dhe psikologë, me pjesëmarrjen e 239 nxënësve.

**4. Hartimi i Planit Vjetor të Punës së KKSB-së për vitin 2025.**

Koordinatorja Laureta Thaqi prezantoi objektivat dhe aktivitetet kryesore për planin e vitit të ardhshëm, duke u fokusuar në përmirësimin e sigurisë publike, ndërtimin e një komuniteti më të sigurt dhe rritjen e bashkëpunimit mes institucioneve dhe qytetarëve. Linkun e planit e gjeni: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/?p=200042126

**5. Orari i mbledhjeve për vitin 2025.**

Të gjithë anëtarët e KKSB-së u pajtuan unanimisht mbi orarin e mbledhjeve të ardhshme, duke planifikuar një qasje të rregullt dhe efektive për vitin e ardhshëm.

**6. Të ndryshme**

Në këtë pikë u diskutuan çështje të tjera të ndërlidhura me sigurinë publike në komunë, duke përfshirë shqetësimet dhe rekomandimet e anëtarëve për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes në komunitet.

KKSB mbetet e përkushtuar për të rritur sigurinë dhe cilësinë e jetës së qytetarëve të Komunës së Drenasit, duke bashkëpunuar ngushtë me të gjitha palët e interesuara për adresimin e sfidave lokale.

**Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSB-së:**
**Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Laureta Thaqi**
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)

**Procesverbali aprovohet nga Kryetari: Ramiz Lladrovci**

**Izveštaj odobrava Gradonačelnik:**

Nënshkrimi / potpis

**Data e aprovimit / Datum odobravanja: 08.01.2025**

***Rekomandimet:***

- *Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;*
- *Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;*
- *Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën:* mpb.dsb@rks-gov.net
- *Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën:* Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

*Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.*